

VENDIM
Nr. 185, datë 23.11.2016

**MBI KËRKESËN E TAP AG PËR APROVIMIN E “PROGRAMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE/REGULATORY COMPLIANCE
PROGRAMME” TË RISHIKUAR, PARAQITUR NË BAZË TË OPINIONIT TË
PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR /FINAL JOINT OPINION, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 12, DATË 14.2.2014**

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, në zbatim të direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (direktiva 73/09); Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; vendimit të Komisionit Evropian C (2013) 2949 të datës 16 maj 2013; “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përfundimtarin (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin Itali (AEEGSI), Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Grek (RAE), në vijim Final Joint Opinion; vendimit të Bordit nr. 12, datë 14.2.2014 “Për miratimin e Programit të Përfundimtar Rregullator/ Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion, në kuadër të procedurës së përfundimit të gazsjellësit TAP; kërkesës së TAP AG të datës 17 nëntor 2016, me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përfundimtar Rregullator/Regulatory Compliance Programme” të rishikuar, konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 12, datë 14.2.2014, ka miratuar Programin e Përfundimtar Rregullator/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përfundimit të gazsjellësit TAP.

- TAP AG ka dërguar në ERE në datën 17 nëntor 2016, shkresën me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përfundimtar Rregullator/Regulatory Compliance Programme të rishikuar, si detyrim i seksioneve 4.5.1 dhe 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/ Final Joint Opinion (FJO).

- Drafti i rishikuar, i dorëzuar nga shoqëria TAP AG është diskutuar mes të tre rregullatorëve, AEEGSI, ERE dhe RAE, të cilët kanë rënë dakord për draftin final të Programit të Përfundimtar Rregullator/Regulatory Compliance Programme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Përfundimtar Rregullator/Regulatory Compliance Programme të rishikuar (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë TAP AG, Rregullatorin Italian (AEEGSI), Rregullatorin Grek (RAE) dhe MEI, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti